



Nr. _____ Prot.

Tiranë, me ____ . ____ .2022

SPECIFIKIME TEKNIKE

SERVER

ILLYRIAN GUARD

Dhjetor 2022

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Autoritet kontraktues: Illyrian Guard SHA

1.2. Historiku

"Illyrian Guard" sh.a është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 4 Prill 2019, si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror, për ofrimin e shërbimeve ndaj personave fizikë e juridikë, publikë dhe privatë. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 % të aksioneve të shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a., është Ministria e Brendshme. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime mbështetëse në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj, në zbatim të kompetencave që i njihen kësaj të fundit sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore. Mënyra e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe siguri i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie, për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike. "Illyrian Guard" vjen si një alternativë e re në treg, duke garantuar profesionalizëm, cilësi maksimale si dhe sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit. Përdorimi i teknologjisë së avancuar dhe infrastruktura kontribuon në ofrimin e një shërbimi me cilësi të lartë dhe garanton konfidencialitetin e informacionit. Në fokus të Shoqërisë janë gjithashtu kërkimet teknologjike të thelluara në funksion të sigurisë fizike dhe kibernetike.

Qëllimi i Illyrian Guard SH.A është të implementojmë sistemet më të avancuara ndërkombëtare në funksion të ruajtjes dhe të krijojmë partneritet me kompanitë lider në botë.

1.3. Situata Aktuale në Illyrian Guard SH.A

Aktualisht Illyrian Guard administron të dhënat e drejtorive dhe sektorëve në skedare excel ose word të cilat janë jo të sigurta dhe krijojnë vështirësi në kohe si në aksesim ashtu dhe përpunimin e këtyre të dhënave duke patur parasysh mungesën e një softëare për kryerjen e këtyre procedurave.

Softëare për administrimin e të dhënave kërkon një ambient me kushte optimale dhe me siguri të lartë për funksionimin e tij.

Mundësimi i një zgjidhjeje software për administrimin e të dhënave do të rrisë si eficienten në punë të drejtorive të Illyrian Guard ashtu dhe sigurinë e informacionit.

Në vijim të ofrimit të shërbimit të sigurisë përmes sistemeve elektronike, Shoqëria "Illyrian Guard" ShA aktualisht ka të instaluar në të gjithë Shqipërinë një numër prej 179 sisteme vëzhgimi, 194 sisteme alarmi dhe 77 kamera teke. Pas përfundimit të instalimit kryhet konfigurimi, lidhja e sinjalit dhe kontrolli i sistemeve në Qendrën e Kontrollit përmes 2 mënyrave: Rrjetit Data dhe Internetit.

Aktualisht këto sisteme monitorohen në Qendrën e Kontrollit nëpërmjet programeve:

1. IVMS për sistemet e vëzhgimit
2. IKLAS për sistemet e alarmit
3. KRONOS NET për menaxhimin e eventeve/alarmeve të kamerave të vëzhgimit dhe sistemeve të alarmit.

Programet e sipërpërmendura janë të instaluar nëpër kompjutera me kapacitete të ulëta si të ruajtjes të të dhënave ashtu dhe në procesimin e të dhënave. Këto kompjutera janë jashtë garancisë dhe jashtë planit të amortizimit teknologjik gjë që krijojnë vështirësi dhe vonesa në punën e përditshme të Qendrës së Kontrollit. Duke marrë parasysh se teknologjitë e sotme ofrojnë mundësinë e integritet të disa programeve në një server me parametra dhe performancë të lartë nëpërmjet platformave të virtualizimit është e nevojshme instalimi i një server si për rritjen e performancës , sigurisë së informacionit ashtu dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit të Qendrës së Kontrollit dhe administratës së Illyrian Guard.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi kryesor i këtij projekti është qasja e punonjësve të Illyrian Guard SH.A në një bazë të dhënash të qendëruar nëpërmjet disa softëare të sigurt dhe të aksesueshëm nga administrata

e Illyrian Guard, softëare të cilët do të instalohen dhe konfigurohen në një server cluster me teknologjinë High Availability .

Gjithashtu do të mundësohet ngritja e një storage nëpërmjet të cilit administrata e Illyrian Guard do të ketë mundësinë e aksesimit të file-ve të ndryshëm në formate të ndryshme (video, pdf, Microsoft Office etj).

2.2. Qëllimi

Instalimi dhe konfigurimi i një Server Cluster ka për qëllim ruajtjen e të dhënave të digjitalizuara të shoqërisë Illyrian Guard si dhe integrimin në të të programeve softwerike që aktualisht janë të instaluar nëpër kompjutera.

Konfigurimi i kësaj teknologjie serveri do të shërbejë për një ambient të sigurt dhe eficient për të dhënat të cilat do të digjitalizohen si nëpërmjet software të administratës së Shoqërisë Illyrian Guard SH.A si dhe administrimin e programeve softwerike aktuale.

Këto zhvillime duhet të jenë në përputhje me dispozitat e VKM nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit, si dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Në fund të këtij shërbimi kërkohet të arrihet:

- Instalimi dhe konfigurimi i një server cluster në ambientet dhe sipas parametrave të netëork të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A.
- Instalimi dhe konfigurimi i storage për server cluster sipas kërkesës së Shoqërisë Illyrian Guard SH.A .
- Instalimi dhe konfigurimi i makinave virtuale të cilat do të hostohen në këtë server cluster.
- Integrimi i programeve softwerike aktuale (IVMS, IKLAS, KRONOS NET) të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A në makinat viruale, konfigurimi dhe testimi i këtyre programeve në ambientet e reja.

- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë për procedurat e mirëmbajtjes së server cluster dhe makinave virtuale.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Disa nga supozimet e projektit janë:

- Stafi i autoritetit kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të punojë në një ambient me kultura të ndryshme dhe disiplina të ndryshme pune.
- Stafi i autoritetit kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik duhet të jetë komunikues dhe bashkëpunues.
- Stafi i autoritetit kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet.

3.2. Rrisqet

Disa nga rrisqet që mund të konsiderohen për mbarëvajtjen e projektit janë:

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës mes pjesëtarëve të grupit të punës pranë Illyrian Guard.
- Mos përfshirja e të gjithë aktorëve në implementimin e kërkuar.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” ;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- VKM Nr.177, datë 04.04.2019 “ Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SH.A”

- VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.
- Të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale në respekt të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në veçanti të Nenit 27 “Masat e sigurisë për të dhënat personale” dhe Nenit 28 “Konfidencialiteti i të dhënave” të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Autoriteti kontraktues duhet të lëvrojë, instalojë dhe konfigurojë një server cluster ku të mundësohen administrimi i të dhënave të drejtorive dhe sektorëve të shoqërisë Illyrian si dhe integrimi i software-ve aktualë të Illyrian Guard SH.A.

Autoriteti kontraktues duhet të instalojë dhe konfigurojë makinat virtuale të cilat do të përcaktohen nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A.

Infrastruktura e Virtualizimit të makinave virtuale:

- Siguron menaxhim dhe monitorim të performancës të platformës së virtualizimit.
- Suporton një gamë të gjerë sistemesh operative, gjenerik dhe kompleks; Windows, Linux, etj.
- Ofron mundësinë e migrimit të makinës virtuale në gjendje të ndezur, pa shpëputje të shërbimeve, nga një server fizik në një tjetër.
- Ofron disponueshmëri të lartë të makinave virtuale dhe vijueshmëri të shërbimeve duke mos përdorur shërbimin e ndërlidhjes së sistemeve operative të makina virtuale.
- Përfshin mundësinë e implementimit në mënyrë të automatizuar, të patch-eve ose upgrade të sistemit të virtualizimit.
- Software i virtualizimit përfshin Hypervisor për çdo host/server burimet hardware të cilit do të virtualizohen.

Infrastruktura Virtuale mbështetet në një arkitekturë cluster të përbërë nga 2 servera fizike. Konfigurimi në Cluster mundëson:

- Menaxhimin e infrastrukturës virtuale në makinat virtuale HA brenda cluster-it

- Menaxhimin e 2 hosteve fizike për mbështetjen e makinave virtuale që do të përdorin përdoruesit fundorë.

4.1.2. Hapësira gjeografike që do mbulohet

Dhoma e serverave të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A

4.1.2. Grupet e synuara

Illyrian Guard SH.A

4.1.4. Siguria e Server Cluster

Me lëvrimin e server cluster të Illyrian Guard, ky server duhet të jetë i qëndrueshëm e i besueshëm dhe të ofrojë në çdo kohë kontroll të integritetit dhe plotësisë së informacionit dhe i garantuar nga ndërhyrjet e pautorizuara.

Ai duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që të lejojë akses vetëm për personat e autorizuar, me të drejtat e përcaktuara, duke ofruar mundësinë e përcaktimit të të drejtave dhe në të dhënat që mund të aksesojnë sipas niveleve të aksesit.

4.2 Detyrat specifike

Projekti do ti nënshtrohet fazave të mëposhtme:

FAZA I-LËVRIMI I SERVERIT CLUSTER

- Lëvrimi i serverit cluster në ambjentet e Shoqërisë Illyrian Guard SH.A.
- Vendosja fizike në rack e dhomës së serverit të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A

FAZA II: Instalimi konfigurimi i serverit cluster

- Intsalimi i të gjithë komponenteve të serverit cluster.
- Instalimi i platformës së virtualizimit në serverat fizik.
- Konfigurimi i ndërfaqeve të network dhe komponentëve të tjerë të platformës së virtualizimit.
- Instalimi i makinave virtuale në serverin fizik.

- Konfigurimi i makinave virtuale dhe instalimi i OS në këto makina.
- Konfigurimi në cluster i makinave virtuale të instaluara dhe konfiguruara.

FAZA III: Testimi i funksionaliteteve të serverit dhe makinave virtuale

- Testimi i funksionaliteteve të serverit cluster.
- Testimi i funksionaliteteve të makinave virtuale.
- Testimi i cluster .

FAZA IV: Trajnimi

- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit për procedurat e sigurisë dhe mirëmbajtjes së serverit cluster dhe makinave virtuale .

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Serveri cluster do të instalohet dhe konfigurohet pranë ambjenteve të dhomës së serverave të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A.

5.2. Data e Fillimit dhe Implementimit të Detyrave

Si datë fillimi do të merret “Data e nënshkrimit të kontratës” dhe si periudhë levrimi , do të jetë **1 (muaj)** nga firmosja e kontratës.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal dhe dy kopje:

- **Raporti Fillestar** duhet të prodhohet brenda 1 jave nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo

udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar

- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të dorëzohet jo më vonë se një javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. GARANCIA

Garancia do të jetë për një periudhë 3 vjeçare nga momenti i marrjes në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor .

8. MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja do të kryhet nga operatori i cili do të kryejë lëvrimin e mallit brenda periudhës së garancisë.

9. PLANIFIKIMI PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

| Nr. | Emërtimi | Sasia | Çmimi |
|------------------------------|---|-------|-------|
| 1 | Lëvrim instalim konfigurim server cluster | 1 | |
| 2 | Testimi i komponenteve | 1 | |
| 3 | Trajnim (ditë) | 3 | |
| TOTALI ME TVSH (LEKË) | | | |

10.SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SERVER CLUSTER

Server Cluster i kërkuar duhet të ketë këto specifikime:

| | |
|-------------------|---|
| Server Cluster | Sasi server 2 copë për cluster. |
| Form Factor | I montueshem ne rack, min. Shasi 2U për suport të drives 24 x 2.5". Të ketë të përfshire shinat dhe aksesoret e nevojshëm per montim ne rack. |
| Procesor | Min 2 procesore fizike 16-core me frekuence punimi minimumi 2.4GHz (135W). |
| Piket Procesorit | 30000+ (sipas benchmark.net) |
| Memorie (RAM) | Min 128 GB DDR4 ECC 3200 MHz RDIMM(4x32GB) – e shtueshme deri ne 8 TB (4 TB per processor) |
| Controller | Kontroller RAID SAS/SATA/SSD dhe suport per RAID 0, 1, 10, 5. |
| HDD | Minimumi 2 x 480GB 480GB SATA 6G Read Intensive SFF BC Multi Vendor SSD, te konfigurueshem ne RAID1. Minimumi 5 x 1.2TB SAS 12G Mission Critical 10K SFF BC 3-vite Warranty Multi Vendor HDD, te konfigurueshem ne RAID 5. |
| NICs | Minimumi 1Gb 4-port BASE-T Adapter |
| OS i instaluar | Microsoft Windows Server (16-Core) Datacenter ROK English Software-versioni i fundit. Licensim te 32 coreve te te 2 procesoreve. |
| VM OS i suportuar | ESXi OS ose ekuivalent që të suportojë Linux dhe Windows |
| VGA | Minimumi 1 porte VGA |
| Poëer Supply | Minimumi 2 Redundant 800W Hot Plug Power Supply. |
| Të tjera | <ul style="list-style-type: none"> - Kabllo Fiber Optike, Multimode, LC-LC, kablllo ushqimi te perfshira, - PCIe 4.0 - shpejtesi e larte transferimi te dhenash. - Security - siguron data/privatesi protection ne nivele te larta pavaresisht sistemit te operimit apo konfigurimit hardware. - I pajisur me build-in AI acceleration - Optane SSD - shpejtesi storage ne nivele te larta dhe te krahasueshme me RAM. - Projektuar për workloade të rënda kompjuterike dhe për një gamë të gjerë mjedisesh XaaS. |

| | |
|--------------------------|-----------------------|
| Licensim Virtualizimi | Support min 3 vjecar. |
| Garancia | 3 vjet |